VENDIM
Nr. 521, datë 8.8.2007

PËR PROCEDURAT E BLERJES NGA MINISTRIA E MBROJTJES TË DISA MALLRAVE, TË PËRJASHTUARA NGA RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË PROKURIMIT PUBLIK

(Ndryshuar me VKM nr. 1403[1], datë 27.10.2008)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit dhe drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe të nenit 5 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. *Miratimin e rregullores për procedurat e prokurimit, që do të zbatohen nga Ministria e Mbrojtjes, për prokurimin e mallrave dhe të shërbimeve, që përjashtohen nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik, sipas shkronjave "a" e "b" të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, përcaktuar në shtojcën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.*

2. *Miratimi për prokurimin e armëve, të municioneve apo pajisjeve e materialeve ushtarake, veçmas a si pjesë e një sistemi, që gjykohet se ka ndikim të veçantë në çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, bëhet sipas pikës 15 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.*

3. *Shfuqizuar.*

4. *Analiza, studimi, klasifikimi e vlerësimi i armëve, municioneve apo pajisjeve e materialeve ushtarake, veçmas apo si pjesë e një sistemi, dhe i shërbimeve, të lidhura me to, për të cilat do të zbatohet ky vendim, bëhen nga bordi i modernizimit, i ngritur në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Mënyra e funksionimit dhe përbërja e këtij bordi rregullohen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.*

5. Për realizimin e procedurave për këto blerje Ministria e Mbrojtjes raporton, në mënyrë të hollësishme, në fund të çdo viti, në Këshillin e Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

---

[1] *VKM nr. 1403, datë 27.10.2008 në pikën 2 shprehet;*

''2.Për procedurat e blerjes së mallrave dhe shërbimeve, që përjashtohen nga prokurimet publike, të cilat kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për fazat e mbetura të procesit, të zbatohen rregullat e sipërpërmendura.''